



**PLANI INTEGRUES PËR ZHVILLIM LOKAL (2023-2026)**  
**KOMUNA E VRAPÇISHTIT**

**VRAPÇISHT, 2023**

**PËRMBAJTJA:**

**KAPITULLI I:**

<b>HYRJA:Nevoja për formulim dhe dizajnim të planit integrues për zhvillim lokal .....</b>	<b>2</b>
<b>1.ORGANIZIMI I PËRPEKJEVE .....</b>	<b>2</b>
1.1 Spjegim i shkurtër rreth formulimit dhe dizajnit të PIZHL.....	3
1.2 Qëllimi përfundimtar i PIZHL.....	3
1.3 Rëndësia teorike , praktike dhe metodologjia e dizajnit (struktura).....	4
1.4 Korniza Institucionale (Struktura komunale) .....	5
1.5 Organizimi i komunës së Vrapçishtit (organogrami).....	6
1.6 Referim ndaj dokumenteve strategjike relevante kombëtare,rajonale dhe lokale.....	7
1.7 Formimi i grupit punues të PIZHL-it.....	7

**KAPITULLI II:**

<b>2. <u>VLERËSIMI I EKONOMISË LOKALE</u>.....</b>	<b>8</b>
2.1 Karakteristika Gjeografike të komunës së Vrapçishtit.....	9
2.2 Karakteristikat socio-ekonomike dhe migracioni.....	11
2.3 Prioritetet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal.....	12
2.4 Infrastruktura.....	13
2.5 Hidrografia.....	14
2.6 Analiza konkurruese (SWOT).....	15

**KAPITULLI III:**

<b>3. <u>KRIJIMI I PLANIT INTEGRUES PËR ZHVILLIM LOKAL</u>.....</b>	<b>16</b>
3.1 Vizioni.....	16
3.2 Synimet dhe objektivat.....	17
3.3 Programet implementuese të zhvillimit ekonomik lokal.....	18

**KAPITULLI IV:**

<b>4. <u>IMPLEMENTIMI I PLANIT INTEGRUES PËR ZHVILLIM LOKAL</u>.....</b>	<b>20</b>
4.1 Nga vizioni drejt projekteve.....	21
4.2 Planet akcionale të projekteve të veçanta të strategjisë së PIZHL-it.....	24

**KAPITULLI V:**

<b>5. <u>RISHIKIMI I PLANIT INTEGRUES PËR ZHVILLIM LOKAL</u>.....</b>	<b>28</b>
5.1 Monitorimi dhe evaluimi.....	29

<b>PËRMBLEDHJE DHE KONKLUZIONE:.....</b>	<b>30</b>
--	-----------

## KAPITULLI I:

### HYRJA:Nevoja për dizajnim dhe ndërtim të planit integrues për zhvillim lokal (PIZHL)

#### 1. ORGANIZIMI I PËR PJEKJEVE

Nevoja për dizajnim dhe ndërtim të planit integrues për zhvillim lokal në komunën e Vrapçishtit ka qenë e kahmotshme, prandaj iniciativa jonë ka qenë shumë e mirëpritur nga të gjitha palët e interesuara si të: vetëqeverisjes lokale, sektorit të biznesit dhe të atij joqeveritar.

Sipas ligjit të vetëqeverisjes lokale , janë të definuara edhe kompetencat , ku me theks të veçantë potencohet se komuna obligohet në iniciimin dhe komunikimin si dhe partneritetin ndërmjet tre sektorëve (pushtetit lokal,sektorit të biznesit si dhe atij joqeveritar) në krijimin e planit integrues për zhvillim lokal(PIZHL).Para së gjithash komunat obligohen që t'i definojnë prioritetet e zhvillimit , përkrahjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në nivel lokal si dhe të kenë pjesëmarrje aktive në krijimin e rrjetit lokal të institucioneve për promovimin e partneritetit ndërmjet tyre. Ato , gjithashtu obligohen në krijimin e veprimtarive të reja , zgjerimin e atyre ekzistuese , si dhe të mundësojnë edhe nxitjen e investimeve , sepse në instancë të fundit bizneset paraqesin fuqinë lëvizëse të zhvillimit ekonomik lokal.Dikush duhet të merr përgjegjësinë për fillimin e fokusimit në PIZHL në rajonin lokal.Shpesh(edhe pse jo gjithmonë) është qeveria lokale. Nëse iniciatori nuk është qeveria lokale, është kritike dhe gati e pamundur që të sigurohet procesi pa mbështetjen e qeverisë lokale.

Pasiqë PIZHL është më shumë e mundur të jetë funksion i ri i shumicës së qeverive lokale, është veçanërisht e rëndësishme të fokusohemi në mënyrën e ndërtimit të kapacitetit për zhvillimin dhe implementimin e PIZHL. Me qenë se, PIZHL përfshin shumë disiplina (psh. ekonomike, financiare dhe teknologjike), rrjeti i PIZHL duhet të përfshijë nëpunës qeveritar lokal siç janë planifikuesit, avokatët, ekspertët financiar, ekspertët e ambientit, inxhinjerë, arkitektë, ekspertë të komunikimit dhe kështu me rradhë, duke dhënë në këtë mënyrë shumë mundësi për të ndërtuar ekipe multi-disiplinare që punojnë nëpër departamentet (sektorët) tradicionalë. Përndryshe, ekipi mund të konsistojë prej një personi inicial dhe programi i PIZHL do të fillojë me më pak ambicje dhe do të ketë efektivitet më të ulët.

Për arsye se, lënda është shumë e gjërë, dhe për arsye se ajo duhet të përfshijë marrëdhënie zhvilluese me nivelin privat, joprofitabil dhe qeveritar, është ideale nëse aty ka lidhshmëri të vërtetë dhe të përbërë nga ekipi prej Kryetarit të Komunës ose Shefit Ekzekutiv. Kjo mbështetje do t'i jep ekipit nxitjen për të hulumtuar, zhvillojë dhe implementojë strategjinë. Ka një numër të rrugëve me anë të së cilave PIZHL-funksionet mund të zhvillohen brenda Autoriteteve Lokale Qeveritare .

Në pothuaj gjitha rastet e suksesshme të studimit të zhvillimit ekonomik të qyteteve, personi përgjegjës, shpesh në Zyrën e Kryetarit ose në zyrën e Shefit Ekzekutiv, fillimisht është i emëruar ta merr përgjegjësinë për PIZHL (kjo mund të zgjerohet në njësi specifike ose departamente në një pikë më të largët). Iniciatori përgjegjës mund të harxhojë shumicën e kohës së tij duke mbledhur informata për ekonominë lokale dhe duke identifikuar stakeholderët (pjesëmarrësit) e rëndësishëm. Realisht, ky person do të duhej të ketë PIZHL eksperiencë, duke përfshirë këtu edhe posedimin e kuptimit të qartë të nevojave të biznesit. Kjo nuk është esenciale, pasi që këto aftësi mund edhe të mësohen.

Angazhimi i Kryetarit të Komunës në emërimin e këtij personi me kohë të plotë pune dhe me përgjegjësi dhe burime initiale, është vendimtare.

Këto burime mund të jenë të kufizuara në fillim, por gjithashtu duhet të jenë të mjaftueshme për ta filluar PIZHL, psh. nevojat bazike për zyrë, trajnime për PIZHL nëse janë të nevojshme, dhe buxhet operacional për t'i ndihmuar takimet e stakeholderëve dhe mbledhjen e të dhënave për analizë preliminare të SWOT analizës.

Praktika e mirë gjithashtu dëshmon se grupi punues (intersektorial të komunës, sektorit joqeveritar si dhe sektorit të biznesit) duhet mirë bashkëpunuar për të bërë një planifikim të suksesshëm. Ky grup duhet të përfshijë njerëz prej departamenteve të ndryshme qeveritare lokale që ka gjasa më të mëdha të kenë përgjegjësi profesionale, teknike, politike ose financiare për çështje të prekura nga PIZHL. Duhet të ekzistojnë kushte të referencës dhe sistem formal i raportimit për grupin. Transparenca dhe akseset publike në informata të përdorura ose të gjeneruara nga grupi, është e rëndësishme për kredibilitetin e saj. Së paku një person me kohë të plotë (full time) i PIZHL-it është vendimtar për të siguruar vazhdimësi në proces, por nuk preferohet një gjë e tillë, sepse efektiviteti do të jetë më i lartë, n.q.s. ky grup do të jetë sa më i madh edhe me pjesëmarrës të profileve të ndryshme.

### 1.1 Spjegim i shkurtër rreth formulimit dhe dizajnit të PIZHL

Formulimi dhe dizajni i Planit të Integruar për Zhvillim Lokal (PIZHL) paraqet një domosdoshmëri jo vetëm në aspekt të strukturimit të kapaciteteve institucionale komunale, por njëkohësisht paraqet edhe përgjegjësi ligjore. Pa një mbështetje institucionale nuk mund të funksionojë trekëndëshi midis sektorit publik, privat dhe atij joqeveritar. Sektori publik, në këtë rast komuna duhet të definojë prioritetet e zhvillimit, sektorët me përparësi krahasimtare dhe në këtë drejtim t'i përkrahë të gjitha bizneset, duke filluar nga mikro bizneset familjare, ato të vogla dhe të mesme dhe të bëhet urë lidhëse për promovim dhe mbështetje të tyre në të gjitha aspektet e zhvillimit, parasëgjithash duke insistuar krijimin e kushteve elementare infrastrukturale. Në suaza të përgjegjesisë ligjore, komuna duhet të ndërtojë *"Planin Integrues për zhvillim lokal"*, me të cilën do të përcaktojë kahjet e këtij zhvillimi, format e përkrahjes dhe instrumentet që i posedon ajo. Në këtë funksion është edhe ky punim që ka për qëllim, me qasje dhe metodologjinë adekuate të Bankës Botërore për plane integruese të zhvillimit lokal, të kontribuojë në këtë drejtim, konkretisht duke na mundësuar në këtë mënyrë përpilimin e dokumentit bazik *"PLANI INTEGRUES PËR ZHVILLIM LOKAL (2023-2026) - Rasti i komunës së Vrapçishtit"*.

### 1.2 Qëllimi përfundimtar i PIZHL

Qëllimi i studimit është që të vë në qendër të analizës dokumentin bazik për një komunë që definojnë, strukturon, priorizon dhe planifikon zhvillimin ekonomik lokal, ku në rastin konkret është komuna e Vrapçishtit. Edhe pse një pjesë e praktikave nga komunat tjera tregojnë se këto dokumente strategjike më herët janë "përshkruar dhe depozituar nëpër sirtarët", në rastin konkret të komunës sonë nuk egziston një dokument i tillë strategjik, por ekzistojnë dokumente tjera strategjike nga më herët, prandaj rezultati direkt i këtij studimi do të jetë dizajni dhe

draftimi i një dokumenti të tillë konkret “Plan i Integruar për zhvillim lokal”(PIZHL).Do të mundohemi që të japim kontributin tonë në unifikimin e të gjitha dokumenteve strategjike që janë në disponim deri më tani, mandej me analizë dhe qasje serioze drejtpërsëdrejti do të kontribuojmë në etablimin dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale në komunë.

Njëherit në këtë proces të studimit krijohen kapacitete lokale për trajtim të këtyre problemeve dhe mundësohet që të debatohet reth perspektivave të zhvillimit ekonomik lokal,duke u bazuar në kriteret e caktuara të zhvillimit të qëndrueshëm dhe e udhëzon menaxhmentin më përgjegjës të komunës në fjalë që për këto aspekte të etablohet bazë e të dhënave dhe vendimet të realizohen mbi bazë të analizave dhe studimeve shkencore. Andaj, me të drejtë pritet që ky angazhim të vlerësohet edhe nga vetëqeverisja vendore (administrata) e komunës dhe njëkohësisht të paraqesë një rast optimal që do të kontribuonte në funksion të angazhimeve të mëtutjeshme në këtë drejtim.

### **1.3 Rëndësia teorike , praktike dhe metodologjia e studimit (struktura)**

Në aspekt teorik , zhvillimi ekonomik lokal paraqet një proces bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik,bizneseve dhe sektorit joqeveritar,në funksion të përmirësimit të kualitetit të jetesës së të gjithë qytetarëve në suazat e komunës.Mirpo, në aspekt praktik , zhvillimi ekonomik lokal do të thotë angazhim maksimal në mënyrë direkte për të krijuar kapacitete të rrethit lokal për zhvillimin e ardhmërisë ekonomike.Para së gjithash,këtu vjen në shprehje dhënja prioritet ekonomisë lokale nëpërmjet rritjes së kapacitetit produktiv të firmave lokale, të cilat janë në vazhdimësi në ballafaqim të sipër me botën e ndryshimeve të shpejta. Pra, ato gjenden në procesin e adaptimit ndaj ambientit të tregut (rrethina),i cili është tepër i ndryshueshëm dhe gjithnjë më konkurrent. Për të arritur ndërtimin e një ekonomie lokale të qëndrueshme , para së gjithash, duhet të kryhet një hap vendimtar në procesin e bashkëpunimit dhe ndërmarrjes së akcioneve duke u mbështetur në forcat dhe dobësitë (faktorë të brendshëm) , si dhe rastet dhe kanosjet (faktorë të jashtëm),që përndryshe paraqesin të ashtuquajturën SWOT-analizën.

Procedura vazhdon me krijimin e Planit të Integruar për Zhvillim Lokal (PIZHL), që paraqet edhe esencën e procesit të planifikimit strategjik që në vehte ngërthen disa komponenta si : vizionin, qëllimet, objektivat dhe programet. Deri këtu , mund të konstatohet se është duke vepruar në aspekt teorik dhe vlerësohet se rëndësia e aspektit praktik mund të vërehet në vazhdim, respektivisht duke filluar nga faza vijuese d.m.th.nga implementimi i PIZHL-it ,i cili paraqet pikën e integritit të elementeve dhe komponentave të lartëpërmendura nga aspekti teorik në atë praktik,duke filluar procesin e implementimit nëpërmjet planeve akcionale. Këto plane përmbajnë : detyrat dhe përgjegjësitë, tabelat kohore të realizimit,resurset humane,burimet e financimit,rezultatet etj. Realizimi i disa planeve mund të implementohet për një afat më të shkurtër kohore, ndërsa disa të tjera mund të jenë afatmesme dhe afatgjate, varësisht nga prioritetet e caktuara në fillim.

Metodologjia e hulumtimit përgjatë studimit konkret, paraqet metodologjinë sipas kriteriumit të caktuar të Bankës Botërore , duke u nisur nga fakti se metodologjia në fjalë paraqet një mundësi perfekte për formulimin dhe dizajnimin e Planit të Integruar për Zhvillim Lokal , duke u bazuar në përvojat nga shumë raste konkrete tjera.Sipas kësaj metodologjie, procesi i panifikimit strategjik zakonisht ka pesë faza dhe paraqet një proces fleksibil ku njëra fazë shpesh vazhdon në mënyrë paralele me një tjetër ,duke mundësuar ndërmarrjen e aksioneve varësisht nga prioritetet dhe mundësitë e kapaciteteve lokale.

Procesi i zhvillimit të PIZHL-it është :

- *Faza 1: Organizimi i përpjekjeve;*
- *Faza 2: Vlerësimi i ekonomisë lokale (vendore);*
- *Faza 3: Krijimi i PIZHL-it;*
- *Faza 4: Implementimi (zbatimi) i PIZHL-it;*
- *Faza 5: Rishikimi (shqyrtimi ) i PIZHL-it ;*

#### **1.4 Korniza Institucionale (Struktura komunale)**

Në bazë të nenit 38 dhe neni 62 alinea 1 nga Ligji për vetëadministrim lokal(fl.zyrtare e R.M nr.05/02),neni 69 alinea 1 nga Statuti i Komunës së Vrapçishtit (Bul.Zyrtar i Komunës së Vrapçishtit nr.04/05)dhe neni 6 alinea 1 nga regullorja e punës së Këshillit të Komunës së Vrapçishtit (bul.zyrtar i Komunës së Vrapçishtit nr.15/06), Këshilli i Komunës së Vrapçishtit në seancën e mbajtur me datë 11nëntor 2021 vit solli vendim për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit të Komunës së Vrapçishtit (nga zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021), në përbërje prej 19 këshilltarëve dhe ate: Aleanca për Shqiptarët (8 këshilltarë), Bashkimi Demokratik për Integrim ( 7 këshilltarë), Partia Demokratike e Turqëve (3 këshilltarë) dhe Lëvizja Besa (1 këshilltar).

Organet e komunës së Vrapçishtit janë strukturuar në këtë mënyrë:

- Kryetari i komunës,
- Këshilli i komunës,
- Administrata komunale,
- Sekretari i komunës,

Vijojnë tre sektorët dhe ate:


- 1.Sektori Juridiko –Normativ, Punë të Përgjithshme Administrative dhe Veprimtari Publike me dy nënsektorë ,
- 2.Sektori për çështje financiare me dy nënsektorë,
- 3.Sektori për Urbanizëm,Mbrojtje të Mjedisit Jetësor,Veprimtari Komunale,Komunikacion, Rugë dhe Zhvillim Ekonomik Lokal .

Pasojnë tre nënsektorët (njësi) tjerë dhe ate:

- 1.Nënsektori për mbikqyrje të inspektionit-Inspektorati,
- 2.Nënsektori për Resurse Humane dhe
- 3.Nënsektori për Revizion të Mbrendshëm.

1.5 Organizimi i komunës së Vrapçishtit (organogrami)

**KOMUNA E VRAPÇISHTIT  
ORGANOGRAM (Figura:1)\***



\*Të dhënat në figurën 1 (organogrami) janë të siguruar nga nënspektori (njësia) e ZHEL -it

### **1.6 Referim ndaj dokumenteve strategjike relevante , kombëtare, rajonale dhe lokale (integrimi vertikal dhe horizontal)**

Referimi ndaj dokumenteve strategjike relevante fillimisht kombëtare, mandej ndaj atyre rajonale dhe më në fund të atyre lokale është i pashmangshëm. Në këtë rast në fakt i referohemi lidhjes vertikale dhe horizontale. Me theks të veçantë këtu duhet përmendur fillimisht referimin ndaj "Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm", që u miratua në shtator të vitit 2015, nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork. Maqedonia si dhe shtetet fqinje mundohen me përpikmëri në realizimin e 17 objektivave të kësaj agjende që në fokus të veçantë e ka reduktimin e varfërisë, zhvillimin social dhe me theks të veçantë zhvillimin ekonomik lokal. Implementimi i objektivave në nivel lokal do të jetë një ndërmarrje e gjerë, intenzive dhe e rëndësishme në rrugën drejt arritjes së sukseshme të qëllimeve ambicioze të AZHQ-2030.

Referimi në nivel rajonal ka të bëjë rreth dy dokumenteve strategjike rajonale dhe ato : "Programa për punë të rrjetit për Zhvillim Inkluziv Rural të Rajonit Planor të Pollogut (2017-2019)" dhe "Strategjisë për Zhvillim Rajonal të R.M. (2009-2019)- Rajoni Planor i Pollogut".

Referimi në nivel lokal përshin pesë dokumente relevante që janë përdorur si orientim për përpilimin e dokumentit që aktualisht jemi duke e përpiluar- PIZHL. Dokumentet relevante janë: "Strategjia për zhvillim rural(2010-2013)-Komuna e Vrapçishtit" , "Strategjia e ZHEL-it (2013-2015)- Komuna e Vrapçishtit" , "Propozim-Plani strategjik për përmirësimin e mirëkuptimit ndërkulturor në komunën e Vrapçishtit " (2014) , "Plani i veprimtimit lokal për personat me nevoja të veçanta në komunën e Vrapçishtit (2016-2017)" , "Korniza strategjike për inkluzivitet social në komunën e Vrapçishtit (2017-2021) dhe " Revizioni urban i komunës së Vrapçishtit" (2020).

### **1.7 Formimi i grupit punues të PIZHL-it**

Pas ndërmarrjes së iniciativës për ndërtimin e PIZHL-it dhe pas përkrahjes nga Kryetari i Komunës, vazhdoi angazhimi në autorizimin e personave të punësuar në administratën komunale ,që më konkretisht në këtë drejtim u angazhua Nënsektori për Zhvillim Ekonomik Lokal ,duke premtuar kushte optimale dhe një buxhet operacional nga ana e Kryetarit të Komunës. Kështuqë u plotësua njëri dimension (i sektorit të vetëqeverisjes lokale) duke vazhduar me angazhimin në gjetjen dhe zgjedhjen e personave adekuate nga sektori i biznesit dhe atij joqeveritar. Në esencë, qëllimi është që të zgjidhen persona që me të vërtetë i takojnë profileve të ndryshme dhe kanë përvojë dhe vullnet në drejtim të zhvillimit ekonomik lokal. Më në fund me një angazhim serioz arritëm që t'i përzgjedhim këta pjesëmarrës që mandej të njëjtët së bashku paraqesin edhe grupin punues të PIZHL-it.

Me formimin e këtij grupi punues pritet që takimet dhe bashkëpunimi të jetë i nivelit të lartë dhe të ketë një koordinim gjithëpërfshirës gjatë procesit të planifikimit integruar për zhvillim lokal dhe ate duke filluar që nga faza fillestare dhe duke vazhduar deri në fazën përfundimtare.



## KAPITULLI II:

### 2. VLERËSIMI I EKONOMISË LOKALE

Hapi i parë për vlerësimin e ekonomisë lokale është duke e bërë të mundur angazhimin për të ndërmarrë në shqyrtim çdo sektor në komunë, për të identifikuar rregullat, procedurat dhe rregulloret e qeverisjes, dhe për të përcaktuar se si këto janë të menaxhuara në drejtim të *efikasitetit, efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies* (kriteret e qeverisjes së mirë). Përderisa ky rishikim i brendshëm është duke u zhvilluar, bizneset duhet të jenë të angazhuar në procesin e PIZHL-it nëpërmjet anketave dhe fokus grupeve të biznesit për të krijuar një bashkëpunim me OJQ-të dhe për të kontribuar në trekëndëshin (komuna, bizneset dhe shoqatat), për grumbullimin e informatave relevante. Të udhëheqish me vlerësimin e ekonomisë lokale përfshin përmbledhjen e informatave relevante dhe me rëndësi strategjike dhe pastaj në vazhdimësi kryerjen e analizës së tyre. Një vlerësim i thellë i ekonomisë lokale ofron themelet për një zhvillim të suksesshëm dhe strategjik të ekonomisë lokale. Të dhënat prej një vlerësimi të tillë ofrojnë një bazë të rëndësishme për themelimin e qëndrimeve të përbashkëta në mes të grupit punues si dhe për vizionin e programit për zhvillimin e ekonomisë lokale.

#### Informatat relevante për ZHEL

Disa lloje të dobishme relevante të informatave që duhet të grumbullohen janë:

- **Informata gjeografike** - karakteristikat gjeografike të komunës.
- **Informata demografike** - informatat për popullatën e komunës.
- **Informata për ekonominë** - kjo informatë do të ofrojë një kuptim për ekonominë lokale.
- **Informata për mundësimin e atmosferës për biznes** - kjo do të jep një analizë të asaj se si qeverisja lokale ndihmon bizneset në sektoret formale dhe joformale.
- **Informatë për infrastrukturën e rrëndë** - kjo do të informojë për statusin e transportimit, telekomunikimit, lëndës djegëse, ujit, elektricitetit, etj. Ky fokusim duhet të jetë në rajonet biznesore.
- **Informata rajonale dhe regjionale** - kjo nënkupton mbledhjen e informatave për atë se çka ndodh në rajonet tjera që influencojnë popullatën në aspekt të ZHEL-it.

#### Këshilla dhe udhëzime për mbledhjen e të dhënave (informatave)

Mbledhja e të dhënave mund të zgjasë pafund dhe disa herë mund ta konsumojë tërë buxhetin e PIZHL-it. Qytetet e suksesshme shpesh janë shumë strategjike lidhur me tipin (llojin) e informatave të cilën ato e mbledhin. Kur mbledhen informatat, është e dobishme të pyetet: "Për çka do të përdoret materiali i mbledhur?". Në qoftë se nuk ka buxhet të mjaftueshëm për një analizë të tërthortë të të dhënave, atëherë grupet fokusuese dhe hulumtuese, dhomat e tregëtisë, anëtarët, udhëheqësit e sektorit publik dhe biznesor, dhe njerëz të tjerë të pranuar për nga njohuritë, mund të jenë një opcion mjaft i dobishëm. Futja e palëve të interesuar në grupin punues për t'i parashikuar apo udhëhequr mbledhjet dhe analizat e të dhënave është e domosdoshme, por është kritike për fitimin e pëlqimit dhe mirëkuptimit reciprok përgjatë procesit .

Ndarja e progresit dhe stimulimi i debateve lidhur me informacionet e mbledhura, është pjesë e procesit që shkon drejt zhvillimit të vizionit të përbashkët. Konsultantët lokal mund të jenë të rëndësishëm për të siguruar se ky angazhim paraqet një ushtrim i mbrendshëm apo vendas.

## 2.1 Karakteristikat gjeografike të komunës së Vrapçishtit

Komuna e Vrapçishtit është e vendosur në veri-perëndim të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në shpatet e maleve Shar prej 580 metra mbi nivelin e detit dhe është komunë rurale që nga veriu kufizohet me komunën e Bogovinës, në lindje dhe juglindje nga komuna e Gostivarit dhe Bërvenicës kurse nga perëndimi me komunën e Restelicës (Republika e Kosovës ). Niveli i arsimimit është në normën e rritjes, e cila është një lloj treguesi që do të jetë arsye për të zhvilluar ndërtimin e objekteve industriale. Struktura agrare është: kullota më të zakonshme me 5336 ha, tokë të punueshme me 4.820 ha dhe 4.686 ha pyje. Komuna përbëhet nga pesëmbëdhjetë fshatra .Mundësi për zhvillimin ekonomik lokal më të shpejtë në komunën e Vrapçishtit është parë në ndërtimin e zonës industriale që shtrihet mbi sipërfaqe prej 250 hektarë, përreth autostradës Gostivar-Tetovë . Edhe pse zona nuk është e urbanizuar, megjithatë, interesi i investitorëve vendas dhe të huaj është shumë i madh. Deri më tani rreth 30 ndërmarrje të vogla dhe të mesme kanë ndërtuar impiantet (objektet), dhe interesi është në rritje dy herë më shumë, por ende ka pasiguri ndër investitorët që kërkojnë garanca të forta për ndërtimin nga ana e komunës. Ka një numër i të rinjve të arsimuar në nivelin universitar dhe vazhdimisht rritet numri i tyre. Pothuajse çdo familje ka nga një anëtar i cili ka përfunduar studimet në Universitet. Përveç tyre ka një numër të studentëve që studiojnë në Universitetet në Shkup, Manastir, Tetovë, Prishtinë, Beograd, Sarajevë, Stamboll, Ankara, Eskishehir dhe vende të tjera. Sot, komuna e Vrapçishtit ka katër shkolla fillore komunale qendrore dhe shkolla e mesme komunale (gjimnazi),që gjendet në fshatin Negotinë dhe numron 110 nxënës dhe 14 klasa.

**Tabela – 1: Stuktura e arsimit fillor në komunën e Vrapçishtit:**

Nr:	Shkolla fillore komunale:	Vendi:	Nr. i nxënësve:	Nr: i klasave:
1.	Sh.F.K. Vrapçishti	Vrapçisht	540	62
2.	Sh.F.K. Mehmet Deralla	Gradec	403	27
3.	Sh.F.K. Naim Frashëri	Negotinë	596	68
4.	Sh.F.K. Sali Lisi	Dobërdoll	466	48
<b>Gjithsejt:</b>			<b>2005</b>	<b>205</b>

\*(Të dhënat për arsimin janë siguruar nga përgjegjësi i njësisë komunale për arsim)

Janë gjithashtu katër stacionet shëndetësore (ambulancat) në Vrapçisht , Gradec, Negotinë dhe Dobridoll . Komuna është e lidhur me rrugë të asfaltuara dhe në të zhvillohet jeta kulturore dhe sociale dhe e gjithë kjo jep një pamje të bukur Vrapçishtit duke e paraqitur atë si një qytet të vogël modern. Komuna e Vrapçishtit (objekti i komunës) është në f.Vrapçisht që gjindet në mes të qyteteve Tetovë dhe Gostivar, në luginën e malit Shar, në pjesën veriperëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe përshfshin një pjesë të madhe të luginës së Pollogut.Vrapçishti që më herët e deri në vitet e gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar ka qenë komunë në vehte dhe paraqet një vendbanim karakteristik dhe specifik ku përveç shqiptarëve jetojnë edhe etnitete tjera . Kufizohet me Komunat e Bogovinës, Bërvenicës, Gostivarit dhe në perëndim me Republikën e Kosovës. Si mjedis rural përfshin përafërisht 192 km<sup>2</sup>,me numër të përgjithshëm të banorëve prej 31129 banorë (rezidentë dhe jorezidentë) dhe është mjedis multietnik në të cilin jetojnë: shqiptarë, turq, maqedonë dhe pjesëtarë tjerë .Si komuna rurale (Ish komuna e Vrapçishtit dhe ish komuna e Negotinës së Pollogut), funksionojnë prej vitit 1996, kurse në mandatin e tretë te pushtetit lokal me bashkimin e tyre u formua Komuna e Vrapçishtit si një komunë e përbashkët dhe e vetme në tërë teritorin edhe të ish komunës së Negotinës së Pollogut.

**Harta e RMV**



Komuna e Vrapçishtit i mbulon vendbanimet në vijim:  
 f.Vrapçisht, f.Dobërdoll, f.Gradec, f.Negotinë, f.Senakos, f.Toplicë,f.Gallatë,f.Zubovcë,f.Kalisht,  
 f.Lomnicë ,f.Gjurgjevisht, f.Vranjofcë, f.Pozharan, f.Gorjan, dhe f.Novosellë.

**-Vendbanimet dhe Popullsia**

Në komunën e Vrapçishtit hynë 15 vendbanime dhe ate fshatrat:  
 Vrapçisht,Dobërdoll,Gradec,Negotinë,Senakos, Toplicë, Gallatë,Zubovcë,Kalisht,  
 Llomnicë,Gjurgjevisht,Vranjofcë,Pozharan,Gorjan,dhe Novosellë.  
 Ne rënzë te malit Sharr janë fshatrat Gradec,Senakos,Negotinë,Dobërdoll,Toplicë,Vrapçisht dhe  
 Zubovcë ndërsa vendet kodrinoro malore janë fshatrat: Vranjofcë,Novosella,Pozharani,  
 Kalishti,Llomnica ,Gjurgjevishti,Gallata dhe Gorjani.

Komuna e Vrapçishtit paraqet qendër kulturo-arsimore ,administrative dhe ekonomike  
 në këtë pjesë të Pollogut të epërm dhe sot objekte të komunës janë ndërtesa komunale e  
 Komunës së Vrapçishtit ku janë të angazhuara udhëheqsitë e komunës me Sektorin e Financave  
 dhe Sektorin Juridik dhe ish ndërtesa e Komunës së Negotinës së Pollogut në të cilën gjendet  
 sektori i Urbanizmit dhe Inspektoriati.

Në bazë të regjistrimit të vitit 2021 nga Enti Shtetëror i Statistikave të R.M.V. ,  
 struktura (përqindja ) etnike është si vijon:

**Tabela – 2: Struktura etnike në përqindje e popullatës:**

Nr.	Perkatësia etnike:	Përqindja:
1.	Shqipëtarë	76.15 %
2.	Turq	15.62 %
3.	Maqedonas	4.41 %
4.	Të tjerë	3.82 %

Buxheti total i komunës së Vrapçishtit për vitin fiskal 2023 është planifikuar të jetë 399.262.893,00 den. Burimet e planifikuara buxhetore e përbëjnë të ardhurat (të hyrat):

**Tabela – 3: Struktura dhe shuma e të ardhurave (të hyrave) në buxhetin e komunës së Vrapçishtit:**

Nr.	Të hyrat:	Shuma ( MKD)
1.	Të ardhurat tatimore	50.515.656,00 den.
2.	Të ardhurat jotatimore	4.490.000,00 den.
3.	Të ardhurat kapitale	21.000.000,00 den.
4.	Transfere dhe donacione	323.000.000,00 den.
5.	Detyrime të brendshme	257.237,00 den.
	<b>Gjithsejt:</b>	<b>399.262.893,00 den</b>

Ky buxhet përbëhet nga njëmbëdhjetë organizata buxhetore (të shpenzimeve të planifikuara) dhe ate:

**Tabela – 4: Struktura dhe shuma e shpenzimeve në buxhetin e komunës së Vrapçishtit:**

Nr:	Shpenzimet:	Shuma ( MKD)
1.	Këshilli i komunës	7.000.000,00 den.
2.	Kryetari i komunës	8.748.140,00 den.
3.	Administrata komunale	38.753.040,00 den.
4.	Shpenzimet kapitale të komunës	4.600.000,00 den.
5.	Planifikimi urbanistik	3.000.000,00 den.
6.	Përkrahje të ZHEL-it	7.471.075,00 den.
7.	Ndriçimi publik	14.500.000,00 den.
8.	Mirëmbajtja dhe mbr. e rrugëve lokale	1.500.000,00 den.
9.	Higjiena publike	400.000,00 den.
10.	Veprimtaria muzikore dhe skenike	4.103.502,00 den.
11.	Arsimi parashkollor,fillor dhe i mesëm	309.127.136,00 den.
	<b>Gjithsejt:</b>	<b>399.262.893,00 den</b>

(Të dhënat buxhetore janë siguruar nga departamenti për buxhet dhe financa)

## 2.2 Karakteristikat socio-ekonomike dhe migracioni

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë një ndër potencialet e zhvillimit ekonomik të komunës së Vrapçishtit ku me theks të veçantë janë fermerët, bujqit privat ,tregtarët etj.

Ka një numër të madh të rinisë të cilët punojnë përkohësisht jashtë shtetit të cilët kontribuojnë në vëndlindje. Në gjatësi prej 13 kilometrave nga punkti për pagesë i autostradës Gostivar ku komuna e Vrapçishtit kufizohet me komunën e Gostivarit në drejtim të autostradës Tetovë deri ne attarin e komunës së Bogovinës , komuna e Vrapçishtit ka shpallur zonën industriale e cila paraqet një perspektivë të mirë për të ardhmen e shoqërisë ,ku janë bërë përpjekje për hapat e para të investimeve që do të thotë vitin e fundit është shfaqur interes për zhvillim të ekonomisë.

Në pjesën e sipërme dmth konkretisht në mes f. Vrapçisht dhe f. Toplicë janë në funksion objektet industriale për përpunimin e drurit , qelqit , përpunimin e mobiljeve etj. ku një pjesë e madhe e qytetarëve të komunes janë të punësuar. Prodhimtari me karakter të njëjtë siç

theksuam më lartë ka edhe në meset lokale të fshatrave: Vrapçisht, Dobridoll, Negotinë, Sanakos dhe Gradec që mund të përmenden si firma më të sukseshme siç janë: Dijamant Eksport, Asa Komerc , DinoTrejdi -Dobridoll ; Gyn-Interier, Fatina, Sezginler, Çelik/Profiles-Vrapçisht, Mazraça, Le-Da-Negotinë; Muzo Kompani, Euro Boden-Senakos; Grafiks, Aus-term , Bekaton-Gradec; dhe firma tjera. Gjithashtu ndërmarrjet hoteljrike dhe shitoret janë zgjeruar në të gjitha lokalitetet. Komuna e Vrapçishtit ka kërkuar dhe do të kërkojë të plotësohen kushtet ekologjike të cilat do të mbrojnë mjedisin jetësor, me atë dhe mjedisin e vet prodhuesit. Në komunë nuk ka asnjë bankë por ekziston bankomati i Stopanska Bankës në f. Negotinë si dhe bankomati i Halkbank në f. Vrapçisht. Gjithashtu në f. Negotinë funksionon dhe Vester Unioni që mundëson transferimin e parave nga bashkëatdhetarët tanë që janë jashtë vendlindjes në vendet evropiane, kryesisht në Zvicër, Itali dhe Gjermani dhe kohët e fundit në Republikën Çeke dhe asaj Sllovaqe. Në dy vendet e para, ata më së shumti punojnë në fabrika, por në Republikën Çeke dhe Sllovaqe, ata kanë dyqanet e tyre të pastiçerive. Ata gjithashtu kanë dyqanet e tyre të pastiçerive në ish-republikat e Jugosllavisë. Përqindja e popullatës së migruar nga komuna jonë synon të jetë rreth 36% dhe në vazhdimësi ka tendencë rritëse , gjë që rezulton në aspektin pozitiv të remitencave.

### 2.3 Prioritetet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal

***Përparsitë kryesore të komunës (që janë caktuar nga njësia e ZHEL-it) janë:***

- Planet urbanistike në zonën industriale ,
- Inicimi i procedurave për zonë ekonomike të lirë dhe,
- Përgatitja për zhvillim të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla si dhe caktimi qëllimeve nga grupi punues .

***Prioritetet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal\* janë:***

- ❖ Përpunimi i planit akcional të përbashkët, duke i marrë parasysh mundësitë për përpunim të planeve akcionale.
- ❖ Formimi i grupit për PIZHL i cili do të jepet nga ana e Kryetarit të Komunës,
- ❖ Përpunimi i PIZHL,
- ❖ Sigurimin e zyrës së ZHEL dhe pajisjen e zyrës me kompjutera, adsl internet, webfaqe të komunës etj.
- ❖ Krijimin e data bazës për format në vijim: të dhëna demografike, institucione arsimore dhe kulturore, sport dhe rekreim, të dhëna për kapacitetet industriale, të dhëna për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të dhëna për sektorin publik, shoqatat joqeveritare , përpilimin e kartave sociale për komunën , shërbime grafiko informative, hapjen e zyrës për informim të qytetarëve (poashtu edhe të mërgimtarëve) dhe hapjen e zyrës për turizëm dhe turizëm malor.

***(\*Prioritetet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal janë të caktuara nga njësia e ZHEL-it)***

Komuna e Vrapçishtit është e lidhur me të gjitha fshatrat në luginën e Pollogut , respektivisht lidhet me magjistralen E-852 e cila prej Shkupi për në Tetovë dhe Gostivar çon drejt qendrave turistike të Ohrit dhe të Strugës. Numri i përgjithshëm i amvisërive është 7509 , që d.m.th. se numri mesatar i çdo familjeje është 4.15 anëtar të familjes, kurse numri i përgjithshëm i amvisërive të banuara është 5155 që do të thotë ka një mesatare prej 3.85 banorësh. Fshat me numër më të madh të banorëve rezidentë është f. Vrapçisht me 4003 banorë, kurse me numër më të vogël është Novosella me 6 banorë. Në lartësi mbidetare më të lartë është f. Llomnicë me lartësi mbidetare prej 1030m, ndërsa në lartësi më të vogël janë f. Dobërdoll, Toplicë, dhe Senakos me lartësi mbidetare prej 570m, kurse lartësia mbidetare e fshatit Vrapçisht është 716m.

Në bazë të regjistrimit sipas Entit Shtetëror Statistikor të R.M.V. të vitit 2021 në komunën e Vrapçishtit struktura nëpër fshatra, me numër të banorëve rezident dhe strukturë të moshës duket si në vijim:

**Tabela – 5: Të dhëna nga Enti Shtetëror për Statistikë i RMV të vitit 2021**

<b>VENDBANIMI:</b>	<b>BANORË:</b>
Vrapçisht	4003
Dobërdoll	3546
Gradec	3934
Negotinë	3068
Senakos	1351
Toplicë	918
Kalisht	511
Gjurgjevisht	198
Llomnicë	118
Vranjofcë	312
Gallate	980
Zubovcë	844
Gorjan	25
Pozharan	28
Novo sellë	6
<b>Gjithsejt:</b>	<b>19842</b>

Në bazë të strukturës së moshës komuna e Vrapçishtit bën pjesë ndër komunat e moshës së mesme dhe ate:

**Tabela – 6: Struktura e moshës së popullatës në Komunën e Vrapçishtit:**

<b>Nr:</b>	<b>Mosha:</b>	<b>Numri i banorëve:</b>	<b>Përqindje:</b>
1.	Prej 0 deri 14 vjet	3771 banorë	19.01 %
2.	Prej 15 deri 64 vjet	14800 banorë	74.59 %
3.	Mbi 65 vjet	1271 banorë	6.40 %

## 2.4 Infrastruktura

Komuna e Vrapçishtit është e lidhur me koridorin 8 dhe është lidhur në komunikacion direkt me komunën e Gostivarit në jug, dhe në veri me komunën e Bogovinës, ne juglindje me komunën e Bërvenicës dhe në perëndim me komunën e Restelicës që gjendet në teritorin e Republikës së Kosovës. Rrjeti rrugor është në funksion edhe me ura që do të thotë se është mirë e ndërlidhur komunikacioni në mes fshatrave që gravitojnë në komunën e Vrapçishtit. Gjithashtu me fshatrat më të mëdha ka një ndërlidhje të mirë të komunikacionit edhe me autostradën Tetovë-Gostivar nëpërmjet dy lidhejve në f. Negotinë dhe në f. Tumçevisht dhe mbikalesën në f. Gradec e cila iu mundëson komunikacion të mirë dhe të lehtë meqenëse fshatrat Gradec, Negotinë, Dobërdoll, Toplicë, Gallatë dhe Vrapçisht janë direkt të kyqura me koridorin i cili i lidh qytetet Gostivar dhe Tetovë. Komuna e Vrapçishtit prej qytetit të Shkupit është në largësi prej 65 km, ndërsa gjithashtu është e ndërlidhur me Aeroportin e Shkupit dhe Aeroportin e Ohrit

nëpërmjet Kërçovës.Nëpërmjet të teritorit të Pollogut të epërm , në teritorin e komunës së Vrapçishtit kalon linja hekurudhore Kërçovë –Shkup, që do të thotë kalon hekurudha me gjatësi prej rreth 13 km.

Lartësia mbidetare e vendbanimeve në komunën e Vrapçishtit duket si në vijim:

**Tabela – 7: Vendbanimet dhe lartësia e tyre mbidetare:**

Nr.	Vendbanimi:	Lartësia mbidetare(metra):
1.	Vrapçishti	716 m
2.	Dobërdolli	570 m
3.	Gradeci	540 m
4.	Negotina	575 m
5.	Senakosi	570 m
6.	Toplica	570 m
7.	Kalishti	840 m
8.	Gjurgjevishti	1.000 m
9.	Lomnica	1.030 m
10.	Vranjofca	800 m
11.	Gallatë	600 m
12.	Zubovca	600 m
13.	Pozharani	920 m
14.	Novosella	600 m

\*(Të dhënat janë siguruar nga webfaqja e komunës së Vrapçishtit)

## 2.5 Hidrografia

Komuna e Vrapçishtit, duke iu falemenderuar burimeve të Malit Sharr është e pasur me një rrjet të madh të burimeve dhe ate me lumin me rjedhje të shpejtë i quajtur Mazraça, i cili kalon nëpër f. Negotinë, i cili nga qytetarët shpesh quhet edhe si lum i egër i cili në vitin 1979 përmbysi gjysmën e fshatit dhe shumë tokë pjellore. Komuna e Vrapçishtit është nën ndikim të klimës kontinentale dhe mediterane dhe modifikimeve të tyre.Pjesët më të ulta kanë vera të thata dhe të ngrohta dhe relativisht dimra të ftohta dhe të lagëta me paraqitje të temperaturave ekstreme (nën-15<sup>0</sup>C dhe mbi 40<sup>0</sup>C).

Lugina është relativisht me diell . Temperaturat mesatare (pranverë-verë) arrijnë prej 20 -40<sup>0</sup>C,ndërsa (vjeshtë-dimër) prej -13<sup>0</sup>C deri 14<sup>0</sup>C dhe me temperaturë mesatare vjetore prej 15<sup>0</sup>C. Temperaturat më të larta arrijnë në korik-gusht,kurse me temperatura më të ulëta janë janari-shkurti.Në periudhën dimërore mbulesa e dëborës në viset më të larta të Malit Sharr është mbi 1 m, e cila mundëson kushte të mira në natyrë gjatë periudhës dimërore.Të reshura të shiut më së shumti ka gjatë pranverës dhe vjeshtës dhe ate në mesatare prej 720mm.Mesatarja vjetore e erës në dimër arrin 14 m/sek,kurse maksimalja arin 25.5 m/sek dhe më së shpeshti frynë era veriore dhe veri-perëndimore. Gjithashtu në fshatin Vrapçisht kemi një prua (Murgovec) i cili kalon ne mes të fshatit ndërsa të gjitha burimet tjera të Sharit nëpërmjet sistemit të grumbullimit të ujërave të Sharrit akumulohen në liqenin artificial të Mavrovës . Ka dhe ujra nëntoksore të cilat qytetarët i shfrytëzojnë si ujë për pije.

2.6 Analiza konkurruese (SWOT)

Tabela- 8

<b>SWOT – analiza</b>	
<b>a) Forca;(përparësi):</b>	<b>b) Dobësi;(pengesa):</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1.Kapacitete ekzistuese humane (punëtore).</li> <li>2. Ka ndërmarrje të vogla dhe të mesme(NVM).</li> <li>3. Komision për marrëdhënje ndëretnike.</li> <li>4. Hapësirë ideale për zonë industriale.</li> <li>5. Posedimi i tokës pjellore për kultivim.</li> <li>6. Potencial njerëzor me pregaditje të lartë.</li> <li>7. Pozita e volitshme gjeografike.</li> <li>8. Sipërfaqe pyjore të mjaftueshme.</li> <li>9. Kullota kualitative e bjeshkëve (blegtori).</li> <li>10. Resurse me burime ujore (Mali Shar).</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Papunësia e madhe dhe standardi i ulët.</li> <li>2. Mosorganizimi i sektorit të biznesit.</li> <li>3. Plani urbanistik i pakompletuar.</li> <li>4. Infrastruktura jo e mirë.</li> <li>5. Niveli i pamjaftueshëm i investimeve.</li> <li>6. Komunikimi i dobët me diasporën(IHD).</li> <li>7. Mospregaditja e materialeve promovuese.</li> <li>8. Mosekzistim i partneritetit publiko-privat.</li> <li>9. Teknologjia e vjetëruar (e prodhuesve).</li> <li>10. Shfrytëzimi joracional i pyjeve.</li> </ol>
<b>c) Mundësi;(raste):</b>	<b>d) Kërcënime;(kanosje):</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Investime nga diaspora.</li> <li>2. Aplikimi i përvojave nga vendet e zhvilluara.</li> <li>3. Trajnimet dhe aftësimet profesionale.</li> <li>4. Stimulimi i ZHEL-it.</li> <li>5. Plani integr. për zhvillim lokal ( PIZHL-i)</li> <li>6. Partneriteti publiko-privat.</li> <li>7. Marketingu dhe promovimi për ZHEL.</li> <li>8. Resurset ekzistuese natyrore.</li> <li>9. Ndërmjetsim për subvencionime të ndryshme.</li> <li>10. Ingerencat e reja te komunës.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Migrimi i te rinjëve jashtë vendit.</li> <li>2. Procedurat e ndërlikuara e IPARD-fondeve.</li> <li>3. Importi i pakontrolluar.</li> <li>4. Ndotja e ambientit.</li> <li>5. Konkurrenca jolojale.</li> <li>6. Mungesa e sigurisë për investime.</li> <li>7. Mospasja plasman për prodhimet.</li> <li>8. Gjykata joefikase(procedurat ligjore).</li> <li>9. Klima politike.</li> <li>10. Korrupcioni.</li> </ol>



## **KAPITULLI III:**

### **3. KRIJIMI I PLANIT INTEGRUES PËR ZHVILLIM LOKAL**

#### **3.1 Vizioni**

Vizioni duhet të zhvillohet dhe pranohet nga të gjithë palët e interesuar. Vizioni duhet të jetë një përshkrim i ardhmërisë ekonomike i preferuar nga stakeholderët për komunitetin. Përderisa vizioni mund të mos jetë plotësisht i realizueshëm, ajo i jep komunitetit një kuptim të qartë për drejtimin. Në bazë të vizionit do të zhvillohen synimet (qëllimet), objektivat, programet, planet akcionare për projektet etj.

Vizioni paraqet përshkrimin e gjendjes së ardhshme të komunës , të dëshiruar nga ana e pjesëmarrësve të grupit punues dhe të komunitetit (sektorëve- privat, publik dhe joqeveritar).

*Vizioni (verzioni përfundimtar) i komunës së Vrapçishtit:*

**Komuna e Vrapçishtit si komunë me popullatë multietnike, me marrëdhënje shumë të mira ndëretnike, me infrastrukturë moderne dhe me sipërfaqe të rregulluar të gjelbrimit, ku jetojnë gjenerata të edukuara dhe të motivuara për një ekonomi lokale të zhvilluar, me zonë industriale të veçantë dhe mjaft atraktive për investitorët.**

### 3.2 Synimet dhe objektivat

Synimet (qëllimet) përcaktojnë në mënyrë më të specifikuar përfundimet që grupi punues tenton t'i arrijë. Qëllimet janë më tepër përshkruese dhe konkrete se sa vizioni dhe duhet të jenë direkt të lidhur me përfundimet nga vlerësimi i ekonomisë lokale (SWOT analiza) ,ndërsa objektiva merr çdo qëllim dhe e ndan atë në disa komponenta.Objektivat janë edhe më specifike. Ato duhet të jenë të lidhura me kohën dhe gjithashtu të matshme. Ato tentojnë t'i rrisin fuqitë, tejkalojnë dobësitë, kërkojnë mundësitë dhe t'i trajtojnë kërcënimet të cilat identifikohen gjatë vlerësimit të ekonomisë lokale.

Në këtë drejtim do të referohemi në përzgjedhjen e synimeve (qëllimeve ) apo drejtimeve kryesore si dhe objektiveve që e karakterizojnë komunën e Vrapçishtit si:

#### **S1: Infrastruktura fizike, që përforcon aktivitetet e biznesit si dhe inkurajon nxitjen e investimeve në funksion të zhvillimit ekonomik lokal.**

**S1:O1:** Deri në fund të vitit 2023 ,të mundësohet aprovimi i planit urbanistik dhe të bëhet implementimi i tij ,në funksion të përmirësimit të infrastrukturës fizike.

**S1:O2:** Që nga viti 2024 e mëtejse ,të sigurohet që sistemi i ujësjellësit dhe i kanalizimit,të plotësojnë nevojat themelore , më së paku të 70% të qytetarëve

#### **S2: Përkrahja e bizneseve ekzistuese private dhe iniciimi i themelimit të NVM-ve të reja, trajnime të personelit komunal dhe të palëve të interesuar.**

**S2:O1:** Deri në fund të vitit 2023, të mundësohet ngritja e nivelit profesional të administratës komunale në shërbim të bizneseve dhe krijimit të partneritetit ndërmjet tyre.

**S2:O2:** Viti 2024 të jetë viti i rritjes së zhvillimit ekonomik lokal dhe viti i nxitjes dhe i dyfishimit të vëllimit të investimeve për vitin 2025 dhe 2026.

#### **S3: Përmirësimi i ambientit jetësor, që mundëson rritjen e kualitetit të jetesës së qytetarëve dhe që krijon mundësi për një mirëqenje më të mirë.**

**S3:O1:** Që nga fillimi i vitit 2023, të mundësohet aprovimi i rregulloreve mbi mbrojtjen e ambientit jetësor.

**S3:O2:** Të arrihet që në vitin 2024, qytetarëve të komunës t'iu mundësohet një ambient i pastër dhe i shëndoshë.

#### **S4: Aktivitete në përmirësimin e zhvillimit të: bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë si dhe të turizmit malor.**

**S4:O1:** Deri në fundi të vitit 2023, të sigurohet mundësia e trajnimit dhe stimulimit të bujqëve dhe të blegtorëve në funksion të rritjes së prodhimtarisë së tyre.

**S4:O2:** Viti 2025 të jetë viti i angazhimit në drejtim të prodhimtarisë dhe përpunimit të drurit si dhe viti i afirmimit të turizmit malor.

Këto angazhime dhe mundësi do të ishin për momentin jo vetëm të mirëseardhura ,por do të kontribuonin në mënyrë direkte në tejkalimin e situatës aktuale dhe do të ishin forca lëvizëse e një zhvillimi të qëndrueshëm lokal ekonomik.

### **3.3 Programet implementuese të zhvillimit ekonomik lokal**

Duke filluar nga krijimi i vizionit dhe duke vazhduar kështu me synimet dhe objektivat e caktuara, pasojnë programet dhe më në fund projektet. Pra, në vazhdim do të angazhohemi në caktimin e programeve implementuese (duke i numëruar projektet që i takojnë programeve të caktuara) të zhvillimit ekonomik lokal.

Programet implementuese:

#### **P1-Programi për hartimin e planeve dhe rregulloreve të administratës komunale .**

1. Hartimi i planit zhvillimor të komunës – Plani Integrues për Zhvillim Lokal (PIZHL-it ).
2. Përgatitja e dokumentacionit teknik për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.
3. Hartimi i planeve urbanistike për tërë teritorin e komunës.
4. Angazhimi në krijimin e zonës industriale përgjatë autostradës Gostivar-Tetovë.

#### **P2-Programi për përforsim të bashkëpunimit ndërkuftar si dhe bashkëpunimi me diasporën.**

5. Mundësia e shfrytëzimit të IPA-fondeve në funksion të bashkëpunimit ndërkuftar .
6. Binjakëzimi i komunës me komuna tjera.
7. Themelimi i një komisioni komunal për koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe diasporës.

#### **P3-Programi për përmirësimin dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.**

8. Pastrimi i shtretërve të lumenjve .
9. Eliminimi i të gjitha deponive ilegale në komunë .

#### **P4-Programi për rritjen e investimeve në drejtim të infrastrukturës fizike.**

10. Adaptimi (renovimi) i nyjeve sanitare të SH.F.K “Sali Lisi”- f.Dobërdoll dhe SH.F.K. “Mehmet Deralla”- f.Gradec.
11. Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjitha vendbanimet e komunës.
12. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në f.Vrapçisht (faza 2),
13. Asfaltimi dhe sanimi i rrugëve në tërë teritorin e komunës.
14. Ndërtimi dhe renovimi i objekteve institucionale-publike.
15. Asfaltimi i rrugës lokale në f. Gradec.
16. Asfaltimi i rrugës Negotinë-Kalisht.
17. Asfaltimi i tre rrugëve lokale në f. Vrapçisht.
18. Asfaltimi i rrugës industriale Negotinë - Gradec.
19. Ndërtimi i sallës sportive në f. Vrapçisht (faza 2).
20. Panela solare në P.K. “SHOTA” –f.Negotinë, SH.F.K. “Naim Frashëri”–f. Negotinë dhe SH.F.K. “Sali Lisi” - f.Dobërdoll.
21. Bazeni për ujë të pijshëm në f. Negotinë.

22. Kej Mazdraça - f.Negotinë.

23. Finalizimi i qendrës ditore për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve me nevoja të posaçme në f. Gradec (faza 2).

**P5-Programi për trajnimin e stafit komunal si dhe palëve tjera të interesuara.**

24. Trajnimi i inspektorëve dhe inkasantëve komunal në funksion të menaxhimit me tatimet .

25. Trajnimi i stafit komunal për hartim dhe menaxhim të projekteve,menaxhim të buxhetit etj.

**P6-Programi për mbështetje teknike dhe administrative të bizneseve, bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe turizmit malor.**

26. Krijimi i fondit për rivitalizimin e bujqësisë , blegtorisë pylltarisë dhe turizmit malor .

27. Promovimi i turizmit malor dhe rural.

**KAPITULLI IV:****4. IMPLEMENTIMI I PLANIT INTEGRUES PËR ZHVILLIM LOKAL**

Pasi të jenë selektuar programet dhe projektet, fillon planifikimi i implementimit. Implementimi i strategjisë është i nxitur nga një plan i gjërë i implementimit, i cili në anën tjetër, është i bazuar në planet akcionale të projekteve individuale. Plani i Implementimit ofron mbështetje buxhetore, resurse humane, institucionale dhe procedurale të implementimit të PIZHL-it. Pikërisht këtu është pika e integritit e të gjitha elementeve brenda PIZHL-it ku plani akcional tregon hierarkinë e detyrave, të palëve përgjegjëse, tabelat realistike kohore, nevojat financiare dhe humane, burimet e financimit, impaktet e pritura dhe rezultatet, indikatorët e performancës, dhe sistemet për evaluimin e progresit për secilin projekt, në mënyrë të veçantë.

Plani implementues, në intancë të fundit, vepron si një mediator (ndërmjetësues) i projekteve të ndryshme dhe planeve akcionale të tyre, në mënyrë që të sigurojë që resurset të mos jenë në kundërshtim, dhe siguron informacion për monitorimim dhe evaluimin e të gjitha palëve pjesmarrëse veçanërisht kryetarit ose shefit ekzekutiv, që edhe domodoshmërisht duhet të japin përgjegjësinë e tyre ndaj komunitetit dhe niveleve më të larta qeverisëse.

Çështjet kuqe që duhet konsideruar në planin e implementimit janë:

- ❖ Kush e merr përgjegjësinë për çdo program ose projekt?
  - ❖ Cilat janë caqet nga aspekti i outputeve, kohës dhe financimit?
  - ❖ Çfarë hapash duhet të ndërmerren që të arrihen qëllimet?
  - ❖ Si do të jenë strukturat e raportimit dhe strategjitë e komunikimit (përfshirë këtu edhe stakeholderët)?
  - ❖ Cilët janë performancat e monitorimit dhe sistemet dhe proceset e evaluimit ?
  - ❖ Çka duhet të ndodhë që të sigurohet se ato janë në vend dhe të përdorura?
  - ❖ Cilat janë kërkesat për burimet buxhetore dhe humane për dorëzim të qëndrueshëm të projektit ose programit?
  - ❖ Implikimet institucionale të ZHEL programeve dhe projekteve, duke përfshirë:
    - Procedurat dhe proceset e reja të Këshillit lokal;
    - Departamentet (njësitë)e reja ose koordinimi inter-departamental që janë të nevojshme për plotësimin e projektit;
    - Efekti i këtij në kapacitetin e funksionimit ekonomik, e cila deri tani nuk ka arritur të menaxhojë implementimin; dhe
    - Aftësitë e reja të kërkuara për implementimin e programeve ose projekteve.
-

4.1 Nga vizioni drejt projekteve

Tabela-9 (Paraqitja tabelare prej vizionit deri në projektet)

Vizioni:	Synimet:	Objektivat:	Programet:	Projektet:
<p><b>Komuna e Vrapçishtit si komunë me popullatë multietnike, me marrëdhënje shumë të mira ndëretnike, me infrastrukturë moderne dhe me sipërfaqe të rregulluar të gjelbrimit, ku jetojnë gjenerata të edukuara dhe të motivuara për një ekonomi lokale të zhvilluar, me zonë industriale të veçantë dhe mjaft atraktive për investitorët</b></p>	<p><b>S1: Infrastruktura fizike, që përforcon aktivitetet e biznesit si dhe inkurajon nxitjen e investimeve në funksion të zhvillimit ekonomik lokal.</b></p>	<p><b>S1:O1: Deri në fund të vitit 2023 , të mundësohet aprovimi i planit urbanistik dhe të bëhet implementimi i tij ,në funksion të përmirësimit të infrastrukturës fizike.</b></p>	<p><b>P1: Programi për hartimin e planeve dhe rregulloreve të administratës komunale.</b></p> <p><b>P2: Programi për përforcim të bashkëpunimit ndërkufitar si dhe bashkëpunimi me diasporën.</b></p>	<p><b>1. Hartimi i planit zhvillimor të komunës – Plani Integrues për Zhvillim Lokal (PIZHL-it ).</b></p>
		<p><b>S1:O2: Që nga viti 2024 e më tutje, të sigurohet që sistemi i ujësjellësit dhe i kanalizimit,të plotësojnë nevojat themelore , më së paku të 70% të qytetarëve.</b></p>		<p><b>2. Përgatitja e dokumentacionit teknik për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.</b></p> <p><b>3. Hartimi i planeve urbanistike për tërë teritorin e komunës.</b></p> <p><b>4. Angazhimi në krijimin e zonës industriale përgjatë autostradës Gostivar-Tetovë.</b></p> <p><b>5. Mundësia e shfrytëzimit të IPA-fondeve në funksion të bashkëpunimit ndërkufitar .</b></p> <p><b>6. Binjakëzimi i komunës me komuna tjera.</b></p> <p><b>7. Themelimi i një komisioni komunal për koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet komunës dhe diasporës.</b></p>

				8. Pastrimi i shtretërve të lumenjve .	
S2: Përkrahja e bizneseve ekzistuese private dhe inicimi i themelimit të NVM-ve të reja, trajnime të personelit komunal dhe të palëve të interesuar	S2:O1: Deri në fund të vitit 2023, të mundësohet ngritja e nivelit profesional të administratës komunale në shërbim të bizneseve dhe krijimit të partneritetit ndërmjet tyre.			9. Eliminimi i të gjitha deponive ilegale në komunë .	
				10. Adaptimi (renovimi) i nyjeve sanitare të SH.F.K. “Sali Lisi”- f.Dobërdoll dhe SH.F.K. “Mehmet Deralla” – f.Gradec.	
				11. Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjitha vendbanimet e komunës.	
	S2:O2: Viti 2024 të jetë viti i rritjes së zhvillimit ekonomik lokal dhe viti i nxitjes dhe i dyfishimit të vëllimit të investimeve për vitin 2025 dhe 2026.			P3: Programi për rritjen e investimeve në drejtim të infrastrukturës fizike.	12. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në f.Vrapçisht (faza 2 ).
					13. Asfaltimi dhe sanimi i rrugëve në tërë territorin e komunës.
					14. Ndërtimi dhe renovimi i objekteve institucionale-publike.
S3: Përmirësimi i ambientit jetësor, që mundëson rritjen e kualitetit të jetesës së qytetarëve dhe që krijon mundësi për një mirëqenje më të mirë.	S3:O1:Që nga fillimi i vitit 2023, të mundësohet aprovimi i rregulloreve mbi mbrojtjen e ambientit jetësor.		P4: Programi për përmirësimin dhe mbrojtjen e ambientit jetësor.	15. Asfaltimi i rrugës lokale në f. Gradec.	
				16. Asfaltimi i rrugës Negotinë-Kalisht.	
				17. Asfaltimi i tre rrugëve lokale në f. Vrapçisht .	
				18. Asfaltimi i rrugës industriale Negotinë- Gradec.	

				19. Ndërtimi i sallës sportive në f. Vrapçisht (faza 2).
				20. Panela solare në P.K. “SHOTA” – f. Negotinë, SH.F.K. “Naim Frashëri “ – f. Negotinë dhe SH.F.K. “Sali Lisi” - f.Dobërdoll.
		S3:O2: Të arrihet që në vitin 2024,qytetarëve të komunës t’iu mundësohet një ambient i pastër dhe i shëndoshë.	P5: Programi për trajnimin e stafit komunal si dhe palëve tjera të interesuara.	21. Bazeni për ujë të pijshëm në f.Negotinë.
				22. Kej Mazdraça- f. Negotinë.
				23. Finalizimi i qendrës ditore për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve me nevoja të posaçme në f. Gradec.
				24. Trajnimi i inspektorëve dhe inkasantëve komunal në funksion të menaxhimit me tatimet
S4: Aktivitete në përmirësimin e zhvillimit të: bujqësisë,blegtorisë, pylltarisë si dhe të turizmit malor.	S4:O1: Deri në fundi të vitit 2023, të sigurohet mundësia e trajnimit dhe stimulimit të bujqëve dhe të blegtorëve në funksion të rritjes së prodhimit të tyre.	P6: Programi për mbështetje teknike dhe administrative tëbizneseve, bujqësisë, blegtorisë, pylltarisë dhe turizmit malor.	25. Trajnimi i stafit komunal për hartim dhe menaxhim të projekteve,menaxhim të buxhetit etj.	
			26. Krijimi i fondit për rivitalizimin e bujqësisë , blegtorisë pylltarisë dhe turizmit malor .	
	S4:O2: Viti 2025 të jetë viti i angazhimit në drejtim të prodhimit dhe përpunimit të drurit si dhe viti i afirmimit të turizmit malor.		27. Promovimi i turizmit malor dhe rural.	



#### 4.2 Planet akcionale të projekteve të veçanta të PIZHL

Konsideratat e rëndësishme të Planit akcional për çdo projekt janë:

- Hierarkia e detyrave ;
- Palët përgjegjëse ;
- Tabelat realistike kohore ;
- Nevojat për burime njerëzore dhe financiare ;
- Burimet për financim ;
- Impaktet e pritura dhe rezultatet; dhe
- Matja e performancës dhe sistemet për evaluimin e progresit për secilin projekt.

Strategjitë më gjërësisht të bazuara dhe të kuptueshme, janë të ofruara (shpërndara) përmes partnershipit të sektorit privat apo publik që janë fortë të nxitur ose të udhëhequr nga autoritetet lokale. Sektori privat shpesh ka vullnet të menaxhojë iniciativa që synojnë përmirësimin e vitalitetit dhe zbatueshmërisë të qendrave të qytetit, ose të jenë të involvuar me iniciativa për zhvillimin e bizneseve. Grupet e komunitetit mund të kërkojnë të udhëheqin iniciativa për përmirësimin e kushteve të shëndetësisë apo amvisërive të një grupi të targetuar të individëve të disavantazuar.

Implementimi i strategjisë nuk është asnjëherë një prerje e qartë si që është zhvillimi i strategjisë. Ajo shpesh merr një kohë më të gjatë se sa që pritet dhe përfshin një ambient konsistent dhe të ndryshueshëm. Brenda çdo projekti dhe programi që implementohet, mendimi strategjik do të ndodh në çdo hap të kësaj rruge. Kjo shpesh do të fokusohet në atë se si më së miri ta avansojmë projektin në një ambient aq shpejt të ndryshueshëm.

Në mënyrë tabelare, këto plane akcionale të projekteve të parapara dhe të veçanta të Planit Integrues për Zhvillim Lokal në komunën e Vrapçishtit, janë të paraqitura si në vijim:

-Plani implementues i projekteve..... (tabela-10),dhe

- Numri i përgjithshëm i projekteve të parapara është 27 , ndërsa struktura e tyre është si vijon:

- a) Infrastruktura institucionale dhe ngritje e kapaciteteve : 11 projekte,
- b) Infrastruktura fizike : 16 projekte.

-Vlera e përgjithshme e investimeve në projektet e identifikuar është **4,940,500** (Euro).

-Burimet e financimit planifikohen që të jenë nga:

- 1) Qeveria lokale.....**1,614,500** (Euro)
- 2) Qeveria qendrore..... **2,075,000** (Euro)
- 3) Donatorët..... **993,000** (Euro)
- 4) Iniciativa të tjera .....**258,000** (Euro) ,ndërsa

-Koha e implementimit dhe e ndikimit të projekteve të parapara është 4 vite dhe ate: 2023-2026

Tabela-10 ( Plani implementues i projekteve - burimet e financimit dhe viti i realizimit )

Nr.	Emri i projektit	Gjithsejt	Qeveria lokale	Qeveria qendrore	Donatorët	Burime tjera	Realizimi (viti)
1.	Hartimi i planit zhvillimor të komunës – Plani Integruer për zhvillim lokal (2023/2026) (PIZHL).	3500	3500	-	-	-	2023
2.	Përgatitja e dokument. teknik për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.	55000	30000	25000	-	-	2023 2024
3.	Hartimi i planeve urbanistike për tërë teritorin e komunës.	120000	40000	-	80000	-	2023 2024 2025 2026
4.	Angazhimi në krijimin e zonës industriale përgjatë autostradës Gostivar-Tetovë.	110000	30000	-	80000	-	2023 2024 2025 2026
5.	Mundësia e shfrytëzimit të IPA-fondeve në funksion të bashkëpunimit ndërkufitar .	550000	-	50000	500000	-	2023 2024 2025 2026
6.	Binjakëzimi i komunës me komuna tjera.	6000	6000	-	-	-	2023-26
7.	Themelimi i një komisioni komunal për koordinimin e bashk. ndërmjet komunës dhe diasporës.	5000	5000	-	-	-	2023 2024
8.	Pastrimi i shtretërve të lumenjve .	50000	10000	-	40000	-	2023-26
9.	Eliminimi i të gjitha deponive ilegale në komunë .	6000	3000	3000	-	-	2023 2024 2025 2026
10.	Adaptimi (renovimi) i nyjeve sanitare të SH.F.K. “ Sali Lisi”- f. Dobërdoll dhe SH.F.K. “Mehmet Deralla“-f.Gradec	50000	-	50000	-	-	2023
11.	Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit në të gjitha vendbanimet e komun.	750000	500000	-	250000	-	2023 2024 2025 2026

12.	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në f.Vrapçisht (faza 2).	400000	150000	-	-	250000	2023 2024
13.	Asfaltimi dhe sanimi i rrugëve në tërë teritorin e komunës.	250000	150000	100000	-	-	2023 2024 2025 2026
14.	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve institucionale-publike.	600000	100000	500000	-	-	2023 2024 2025 2026
15.	Asfaltimi i rrugës lokale në f. Gradec.	250000	50000	200000	-	-	2023 2024
16.	Asfaltimi i rrugës Negotinë-Kalisht.	350000	50000	300000	-	-	2023 2024
17.	Asfaltim i tre rrugëve lokale në f. Vrapçisht.	350000	50000	300000	-	-	2023 2024
18.	Asfaltimi i rrugës industriale Negotinë - Gradec.	250000	50000	200000	-	-	2023 2024
19.	Ndërtimi i sallës sportive në f. Vrapçisht (faza 2).	300000	300000	-	-	-	2023
20.	Panela solare në P.K. "SHOTA "-f. Negotinë, SH.F.K. "Naim Frashëri " -f. Negotinë dhe SH.F.K. "Sali Lisi"-f.Dobërdoll.	25000	-	-	25000	-	2023
21.	Rezervoari për ujë të pijshëm në f.Negotinë.	100000	20000	80000	-	-	2023 2024
22.	Kej Mazdraça - f.Negotinë.	200000	40000	160000	-	-	2023
23.	Finalizimi i qendrës ditore për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve me nevoja të posaçme në f.Gradec (faza 2).	10000	10000	-	-	-	2023

24.	Trajnimi i inspek. dhe inkasan. kom. në funksion të menaxh. me tatimet.	6000	1000	1000	2000	2000	2023 2024
25.	Trajnimi i stafit kom. për hartim dhe menaxhim të projekteve, të buxhetit etj.	4000	1000	1000	1000	1000	2023 2024
26.	Krijimi i fondit për rivitalizimin e bujqësisë , blegtorisë pylltarisë dhe turizmit malor .	20000	5000	5000	5000	5000	2023 2024 2025 2026
27.	Promovimi i turizmit malor dhe rural.	120000	10000	100000	10000	-	2023 2024
	<b>Gjithsejt: (Euro)</b>	<b>4940500</b>	<b>1614500</b>	<b>2075000</b>	<b>993000</b>	<b>258000</b>	

## KAPITULLI V:

### 5. RISHIKIMI I PLANIT INTEGRUES PËR ZHVILLIM LOKAL

*Rishikimi* i Planit të integruar për zhvillim lokal normalisht bëhet në bazë vjetore, shpesh në një konjksion me qarkun e planifikimit financiar të autoriteteve lokale. Edhe grupi i autoriteteve lokale, edhe komiteti drejtues, duhet të jenë të involvuar në procesin e rishikimit. Në fakt, komuniteti lokal duhet të jetë në mënyrë aktive i përfshirë dhe atij duhet që t'i jepet mundësia për një involvim më direkt në të ardhmen. Mbështetja politike, publikimet, dhe dukja e arritjeve janë qenësore në mbajtjen e vrullit dhe gjenerimit të entuziazmit brenda komunitetit duke pasur kujdes të veçantë në përfshirjen e këtyre çështjeve :

- + A është SWOT analiza akoma valide apo kanë ndryshuar rrethanat?
- + A ka më tepër informacion në dorë që ndryshojnë pamjen e çështjeve?
- + A kërkohen ndryshime në vizion, qëllime ose objektiva për të reflektuar ndryshimin e rrethanave?
- + A e arrijnë projektet atë që shpresohet se ato do të arrijnë?
- + Nëse jo, çfarë duhet bërë?
- + Çfarë ndryshimesh duhet bërë?
- + A duhet të ndryshojnë edhe indikatorët?
- + A duhet të ketë më shumë aktivitete në projekte?
- + A duhet të ndryshohen projektet?

Edhe pse zhvillimi ekonomik lokal (ZHEL) është disiplinë relativisht e re, nuk ka mungesë të shembujve për praktikatat e këqija që duhet të nënvizohen për t'u përkujtuar në gabimet e kota potenciale. Një plan i mirëfilltë i monitorimit dhe evaluimit duhet të jetë një komponentë kryesore e Planit të Implementimit. Indikatorët do të determinohen në nivel të projektit për të matur inputet, outputet, përfundimet dhe impaktet për secilin projekt. Këto do të konsolidohen për të përcaktuar suksesin e programit dhe më pas do të konsolidohen në një vlerësim të përgjithshëm të progresit të ZHEL-it . Mbledhjet gjysmëvjetore dhe vjetore të përsëritura për të diskutuar rezultatet, janë të nevojshme si një pjesë e një planifikimi të vazhdueshëm dhe një procesi i të mësuarit. Një punëtori apo seminar strategjik i monitorimit dhe evaluimit , është ide e mirë në fillim të një programi. Ai duhet të nxjer në pah një tabelë me zgjatje kohore me rishikime të skeduluara dhe me përmbajtje, si dhe me indikatorë të procesit. Një auditim i pavarur i indikatorëve kryesore nëpërmjet analizave apo sondazheve përsëritëse të agjensive lokale, qeveritare dhe të bizneseve, është parësore për themelimin e progresit të bërë, që nga linja themelore e vlerësimit të ekonomisë lokale (faza e dytë-që kontribuon në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave) ,deri në fazën përfundimtare.

---

## 5.1 Monitorimi dhe evaluimi

*Monitorimi* është një vlerësim i vazhdueshëm i strategjisë dhe i implementimit të projektit në lidhje me skedulet e pranuar, dhe në përdorimin e inputeve, infrastrukturës, dhe shërbimeve nga përfituesit e projektit. Monitorimi u ofron menaxherëve dhe palëve të interesuar tjerë një feedback të vazhdueshëm nga implementimi. Ai identifikon sukseset aktuale ose problemet potenciale sa më herët që është e mundur që të mund të bëhen përmirësimet në kohë të operacionit të projektit. Monitorimi e pranon dizajnin e projektit ashtu siç është i dhënë, e mat progresin dhe fokusohet në performancën që ndodhën vazhdimisht.

*Evaluimi* është vlerësimi periodik i relevancës së projektit, performancës, efikasitetit, dhe impaktit (të pritur dhe jo të pritur) në varësi me objektivat e parashtruara. Menaxherët e projekteve ndërmarrin evaluime interne gjatë implementimit si një përmbledhje (rishikim) e parë e progresit, si prognozë për efektet e mira të projektit, dhe si një rrugë për të identifikuar përmirësimet e nevojshme në dizajnin e projektit. Evaluimi e sfidon dizajnin e projektit, sjell konkluzione dhe vendime, dhe është e fokusuar në efektivitetin e programit ose projektit, kështu që bëhet një çështje e rëndësishme në qarkun (ciklin) e projektit.

Një sistem mirë i dizajnuar i monitorimit dhe evaluimit do t'u ndihmojë menaxherëve t'i përgjigjen pyetjes "Si do ta di se i kam arritur objektivat e mia?". Ai njëherit ofron bazë për mbështetje dhe përgjegjësi në përdorimin e burimeve. E përdorur me kujdes në të gjitha fazat e ciklit të projektit, monitorimi dhe evaluimi mund të ndihmojnë ta bëjnë më të fuqishme strategjinë dhe dizajnin si dhe implementimin e projektit. Ato gjithashtu mund të stimulojnë një partnership me stakeholderët e projektit. Rëndësia e beneficioneve të regjistruara që në fillim mund të ndihmojë të rforcohet pronësia, dhe paralajmërimi i hershëm i cili alarmon për probleme emergjente dhe mundëson që akcioni të behët para se të rriten kostot. Një sistem mirë i dizajnuar i monitorimit dhe evaluimit, mund të shpalos nevojën për kurse korrektuese. Së fundi, një rrjedhë mbështetëse e informatave gjatë implementimit u lejon menaxherëve që të jenë në hap me progresin dhe t'i rregullojnë operacionet duke e eksperiencuar kështu veten e tyre.

Duke pasur parasysh faktin e angazhimit serioz në përpilimin e PIZHL-it në komunën e Vrapçishtit, mbetet që të konstatojmë se procesi i rishikimit të planit apo fazës së fundit të procesit (monitorimit dhe evaluimit), nuk mund të realizohet. Shpresojmë se kushte reale për procesin në fjalë do të krijohen pas vitit të parë të implementimit të projekteve të parapara në Planin e Integruar të Zhvillimit Lokal (që aktualisht jemi duke e përpiluar).

---

**PËRMBLEDHJE DHE KONKLUSIONE:**

Në aspekt teorik zhvillimi ekonomik lokal paraqet një proces bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik,bizneseve dhe sektorit joqeveritar,në funksion të përmirësimit të kualitetit të jetesës së të gjithë qytetarëve. Mirpo në aspekt praktik , zhvillimi ekonomik lokal do të thotë angazhim maksimal në mënyrë direkte për të krijuar kapacitete të rrethit lokal për zhvillimin e ardhmërisë ekonomike.Para së gjithash,këtu vjen në shprehje dhënja prioritet ekonomisë lokale nëpërmjet rritjes së kapacitetit produktiv të firmave lokale, të cilat janë në vazhdimësi në ballafaqim të sipër me botën e ndryshimeve të shpejta. Pra, ato gjenden në procesin e adaptimit ndaj ambientit të tregut(rrethina),i cili është tepër i ndryshueshëm dhe gjithnjë më konkurrent. Për të arritur ndërtimin e një ekonomie lokale të fortë , duhet para së gjithash të kryhet një hap vendimtar në procesin e bashkëpunimit dhe ndërmarrjes së akcioneve duke u mbështetur në forcat dhe dobësitë (faktorë të brendshëm ) , si dhe rastet dhe kanosjet (faktorë të jashtëm),që përndryshe paraqesin të ashtuquajturën SWOT-analiza.

Në esencë, ky bashkëpunim i ndërmarrjes së akcioneve, paraqet edhe procesin e gjatë të planifikimit strategjik të PIZHL-it , i cili fillon me Organizimin e përpjekjeve (faza e parë).Në këtë fazë,fillon procesi i identifikimit të institucioneve,bizneseve dhe grupeve të tjera që janë të interesuara për zhvillim ekonomik lokal dhe formimin e partneriteteve ndërmjet tyre deri në unifikimin e pikëpamjeve të përbashkëta.

Në fazën e dytë bëhet Vlerësimi i ekonomisë lokale duke mundësuar grumbullimin e të dhënave si dhe kryerjen e analizës së tyre. Procedura vazhdon me Krijimin PIZHL-it (faza e tretë), që paraqet edhe esencën e procesit të planifikimit strategjik që në vehte ndërthen disa komponente si :vizionin,qëllimet,objektivat dhe programet. Deri këtu , mund të konstatohet se është duke vepruar në aspekt teorik dhe vlerësohet se rëndësia e aspektit praktik mund të vërehet në vazhdim, respektivisht duke filluar nga faza vijuese d.m.th.nga Implementimi i PIZHL(faza e katërt). Implementimi i planit paraqet pikën e integritit të elementeve dhe komponenteve të lartpërmendura nga aspekti teorik në atë praktik,duke filluar procesin e implementimit nëpërmjet planeve aksionale. Këto plane aksionale përmbajnë: detyrat dhe përgjegjësitë,tabelat kohore të realizimit,resurset humane,burimet e financimit ,rezultatet etj. Realizimi i disa planeve mund të implementohet për një afat më të shkurtër kohore , ndërsa disa të tjera mund të jenë afatmesme dhe afatgjate,varësisht nga prioritetet e caktuara në fillim. Rishikimi i PIZHL-it, paraqet fazën e pestë respektivisht fazën e fundit të procesit të planifikimit strategjik.Në këtë fazë,mundësohet rishikimi duke përdorur indikatorët e monitorimit dhe evaluimit prej fazës fillestare , duke përcjellur dinamikën e ndryshimeve të kushteve ekonomike lokale dhe rajonale deri në fazën përfundimtare.

Përfundimisht, duhet theksuar se gjatë vlerësimit të efijencës dhe efikasitetit pozitiv të implementimit të planifikimit , komuna do të arsyetohet para qytetarëve për shpenzimet racionale dhe do të respektohen: efikasiteti, përgjegjësia , llogaridhënja si dhe transparenca gjatë përfundimit të procesit. Në fakt, këto parime paraqesin edhe kriteret e "qeverisjes së mirë".

Duke filluar nga faza e parë dhe duke vazhduar kështu drejt rezultateve përfundimtare, arritëm që të krijojmë një koordinim të mirëfilltë me anëtarët e grupit punues si në: grumbullimin e të dhënave,përpunimin si dhe analizën e tyre (SWOT-analiza ),definimin e vizionit, qëllimeve,objektivave,programeve dhe deri në projektet konkrete . Në këtë rast duhet theksuar se gjatë hartimit të PIZHL-it , së bashku caktuam katër punëtori,duke organizuar paraprakisht kohën e takimeve, rendin e ditës etj., ku shtjelluam përveç tjerash edhe aspektet teorike dhe praktike të PIZHL-it ,e cila do të konsiderohet si bazë e Qeverisë lokale të komunës së Vrapçishtit, në periudhën e ardhshme kohore katërvjeçare (2023-2026).

Qëllimi përfundimtar i përbashkët është ,që të krijohen mundësi në krijimin e kushteve më të mira në favor të sektorit të biznesit, forcimin e kapaciteteve të administratës komunale dhe e gjithë kjo duke rezultuar me një partneritet të mirëfilltë reciprok (të vetëqeverisjes lokale, sektorit të biznesit dhe atij joqeveritar). Prandaj në këtë drejtim, në realizimin e drejtë të "planit integrues",përveç tjerash, nevojiten edhe përmirësime adekuate dhe si rrjedhojë e gjithë kësaj, mund që të vijmë në disa konkluzione , si që janë:

*-Angazhimi në gjetjen e mundësive për realizimin e projekteve kapitale (ujësjellësi ,kanalizimi, stacionet filtruese etj.),duke i shrytëzuar mundësitë për kredi të ndryshme (si huamarrja publike), që janë të destinuara për projekte zhvillimore.*

*-Angazhimi në përgatitjen e ekipit profesional që do të mundësojë tërheqjen (thithjen) e IPA-fondeve,duke mundësuar krijimin e partneriteteve publiko-private.*

*-Mundësia e formimit të ekipit të trajnuar të personelit komunal që do të kontribuojë në avancimin e sektorit të biznesit, duke mundësuar krijimin e asociacioneve biznesore.*

*-Mundësia e "shfrytëzimit të rastit" në nxitjen e investimeve të huaja dhe investimeve të bashkëatdhetarëve tanë nga diaspora,duke promovuar dhe prezentuar kapacitetet tona reale.*

*-Mundësia e formimit të njësive për preventivë që i mungojnë komunës tonë si: njësia e zjarfikësve (që është në fazën e formimit) ,njësia për emergjencë (ndihma e shpejtë),njësia për çështje sociale etj.*

*-Mundësia e formimit të komisioneve të sferave të ndryshme si: bujqësia ,blegtoaria, pylltaria, turizmi malor etj.*

Këto angazhime dhe mundësi do të ishin për momentin të mirëseardhura , do të kontribuonin në mënyrë direkte në tejkalimin e situatës aktuale dhe do të ishin forca lëvizëse e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik lokal.



